



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 393, datë 22.09.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN
NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR
POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 290,
DATË 06.07.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, bazuar në rezultatet e shortit për zgjedhjen e relatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR